

Lansohet fushata #edhetimundesh, synon fuqizimin ekonomik të gruas



nga **Ekonomia Online**

Prishtinë | 15 Tetor 2015 | 16:00

Fuqizimi ekonomik i gruas është e drejtë parësore e shoqërisë, është investim i të ardhmes si dhe rrugë për zhvillim ekonomik. Përkundër që janë bërë shumë përpjekje për ta fuqizuar rolin e gruas në shoqëri, statistikatat tregojnë se ka ende punë për tu bërë.

Në Kosovë, vetëm 11 për qind e të gjitha kompanive të regjistruara janë në pronësi të grave. Kjo tregon se gratë nuk janë të perceptuara nga publiku, familjarët, si dhe nga komiteti i biznesit si aktore ekonomike të rëndësishme.

Për ta ndryshuar këtë shifër duhet koordinimi i shumë aktorëve, si institucionet qeveritare, komuniteti i donatorëve, shoqëria civile, dhe më e rëndësishmja vetëbesimi i grave.

Kampanja #edhetimundesh që u lansua sot në Prishtinë, mëton t'i rrisë shkathtësitë e grave për të siguruar në radhë të parë mirëqenie për vete.

Në hapje të kampanjës u tha se ka ardhur koha që të ngritët zëri dhe të shfaqen shembuj pozitivë për rrugën që duhet ndjekur.

Udhëheqësja e projektit "Fuqizimi Ekonomik i Gruas", Erëza Vela-Berisha, njëherësh udhëheqëse e kompanisë "Red Mill Communications" që dizajnuan kampanjën #edhetimundesh, në fjalimin hyrës tha se rrugëtimi deri tek fuqizimi ekonomik i gruas nuk është një gjë e cila bëhet "sa hap e mbyll sytë".

Sipas saj, kjo është një rrugë e gjatë e cila kërkon përkushtim dhe pëmbushje të shumë kriterëve.



Në lansimin e kësaj kampanje e pranishme ishte edhe menaxherja e Projektit PPSE, Sigrid Meijer. Ajo tha se duhet të punohet që të eliminohen shumë sfida, në mënyrë që të kemi një shoqëri punëtore të llojlojshme. “Duhet të zvogëlohen barrierat, gratë duhet të kenë qasje në të drejtat pronësore, trashëgimi si dhe të kenë qasje në kredi pasi që këto janë sfida me të cilat përballen gratë për të hy në biznes”, tha Meijer.

Ambasadorja Zvicerane në Kosovë, Krystyna Marty Lang, foli për rëndësinë e fuqizimit ekonomik të gruas, si dhe ndikimin e saj në ekonominë e vendit. Ajo tha se Kosova ende është një shoqëri tradicionale ku dominojnë meshkujt, dhe se ka një shkallë shumë të ulët të senzibilitetit. Sipas saj, vetëm përmes barazisë gjinore mund të shihen efektet pozitive në ekonomi.

Në anën tjetër, ministrja e Tregtisë dhe Industrisë, Hykmete Bajrami, tha se gratë në Kosovë vazhdojnë të përballen me barrierat e ndryshme që e pamundësojnë avancimin e tyre. “Pesëmbëdhjetë vjet pas luftës ende diskutohet për fuqizimin e grave. Është e vërtetë që gratë përballen me sfida mirëpo ne duhet të jemi ata që i eliminojmë këto, dhe të kërkojmë që të jemi të barabartë”, tha Bajrami.

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Blerand Stavileci tha se për të qenë i suksesshëm secili njeri duhet t'i posedojë tri veçori kryesore: guxim, dije dhe kapital.

Në kuadër të lansimit të kampanjës #edhetimundesh, drejtoresha përgjithshme e Radio Televizionit 21, Afërdita Saraçini-Kelmendi, para të pranishmëve shpalosi ngjarje interesante me të cilat ishte përballur nga momenti kur vendosi të merrej me biznes.

Ajo tha se të gjithë ata që mendojnë se nuk mund të jenë të suksesshëm gabojnë. Sistemi arsimor sipas saj duhet të jetë prioritet sepse nëse një shoqëri edukohet si duhet atëherë më shumë se 80 për qind do të jenë të suksesshëm.

Prezent në lansimin e kampanjës ishin edhe përfaqësues të institucioneve të larta të vendit, përfaqësues nga sektori privat, komuniteti i donatorëve, mediave si dhe ekspertë të kësaj fushe.

Gjatë prezantimet të kampanjës #edhetimundesh para publikut të gjerë u promovuan edhe shembuj të grave si "role-modele", u shpalos eksperiencia e tyre dhe rruga e tyre drejt suksesit.

Kampanja "Fuqizimi ekonomik i Gruas" udhëhiqet nga Red Mill Communications, ndërsa mbështetet nga Projekti për Promovimin e Punësimit në Sektorin Privat – PPSE, i cili implementohet nga Swisscontact si partner kryesor, dhe financohet Zyra e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në Kosovë.